

International Scientific Conference, Tirana, Albania 2011

“Rural tourism: an opportunity for rural development in Republic of Macedonia”

Authors:

Nako Taskov, Ph.D., Dejan Metodijeski, M.Sc., Tatjana Dzaleva, M.Sc., Oliver Filiposki, M.Sc., University “Goce Delcev” - Shtip, Faculty of tourism and business logistics

Abstract

The subject of this paper shall be the rural regions in Republic of Macedonia where there is developed rural tourism. In the paper, the authors will give a definition of rural tourism and the rural tourism enterprises shall be classified by the regions where they occur. It shall discuss the rural tourism enterprises and the impact they have on rural development.

Key words: rural tourism, rural development, rural regions.

“Turizmi rural, mundësia për zhvillim rural në Republikën e Maqedonisë”

Apstrakt

Lëndë e këtij artikulli janë rajonet në Republikën e Maqedonisë, ku zhvillohet turizmi rural. Në këtë artikull autorët do të japin definicionin për turizmin rural, sipërmarrësit të cilët merren me turizëm rural janë të ndarë sipas rajoneve në të cilat veprojnë dhe do të diskutohet për kontributin e tyre në zhvillimin rural. Në fund të këtij artikulli do të silllet përfundimi dhe rekomandimet për zhvillimin e ardhshëm të turizmit rural në vend.

Fjalët kyçe: turizmi rural, zhvillimi rural, rajonet rurale.

1. Përkufizimi i turizmit rural

Sot turizmi paraqet tregues i zhvillimit të civilizimit tonë, për disa njerëz është mënyrë e ngritjes së nivelit të kulturës, argëtim apo shërim, për disa mundësi për përfitim, por duhet të shënohet se turizmi është një nga tregimet e jashtëzakonshme për suksesin në kohën e sotme. Industria, e cila filloi zhvillimin e saj në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar, rritet shumë shpejt dhe sigurisht në 60 vitet e kaluara në krahasim me të hyrat që i gjeneron dhe numrin e njerëzve që udhëtojnë jashtë vendit. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Turizmit, më shumë se 935 milionë njerëz kanë udhëtuar në nivel ndërkombëtar në vitin 2010 në krahasim me 25 milionë njerëz në vitin

1950¹. Potenciali për rritjen e turizmit mund të ndërlidhet si strategji për turizmin rural. Hapësira rurale të cilën e përbëjnë hapësira jashtë qytetit, vazhdimisht transformohet. Numri i banorëve që jetojnë në këtë hapësirë vazhdimisht bie, numri i atyre që merren me bujqësi është i vogël, ndërsa dallimet rajonale në zhvillim gjithnjë e më shumë janë të mëdha². Mjedisi rural përfshin hapësirën natyrore gjeografike në të cilin dominojnë veprimtaritë primare (bujqësia, pylltaria dhe blegtoaria), zakonisht infrastruktura e zhvilluar dobët ekonomike dhe institucionale³. Në shtetet e ndryshme, përcaktimi i llojit të rajoneve rurale bëhet në mënyrë të ndryshme. Për shembull në Angli dhe Vels, si rajon rural konsiderohet ai ku banorët jetojnë në lagje që ka më pak se 10.000 banorë, në Austri ku ka 5.000 banorë, në Australi dhe Kanada 1000 banorë e kështu me radhë. Në Republikën e Maqedonisë mjediset rurale definoohen si zona të komunave, territori i të cilës nuk ka vend të banuar mbi 30.000 banorë apo dendësia e vendbanimit është nën 150 banorë për km katror⁴.

Cila do formë e turizmit, që e prezanton jetën rurale, artin, kulturën dhe trashëgiminë e lokaliteteve rurale dhe në këtë mënyrë kontribuon në zhvillimin social dhe ekonomik të bashkësisë rurale si dhe mundëson interakcionin midis turistëve dhe banorëve lokal dhe begatimin e përvojës turistike, mund të jetë e kushtëzuar si turizëm rural. Turizmi rural mund t'ofroj banorëve mundësi për biznes në industrinë e turizmit. Ju jep mundësi banorëve të zhvillojnë shkathtësitë afariste dhe hapësirë të zejtarëve lokalë, fermerëve dhe prodhuesve të ushqimit për të shitur prodhimet e tyre në objekte lokale të shitjes me pakicë, popullarizimi i të cilëve do të rritet me praninë e turistëve. Fermerët të cilët kultivojnë perime të freskëta dhe pemë si dhe ata banorë (zakonisht gratë) që prodhojnë xhem, ëmbëlsira, pjekin pogaçe dhe bëjnë lloje tjera delikatesave lokale që menjëherë mund të konsumohen, kanë mundësi për formimin e kanaleve të drejtpërdrejta të marketingut. Gjithashtu do të rritet kërkesa për art primitiv.

Foiera⁵ e trajton turizmin rural si tërësi e të gjitha llojeve dhe formave të turizmit, të praktikuara në mjedisin rural. Vëmendja përqendrohet në kontrastin midis mjedisit rural dhe të qytetit. Sipas autorit turizmi rural është lloji themelor i turizmit, i cili përfshin në vete të gjitha format e turizmit të praktikuar në mjedisin rural.. Foiera nuk parasheh ofertën e detyrueshme turistike për të kështu kryerjen e punëve afariste të fshatit. Kriteri është jo ai i cili zhvillon turizmin rural, por ku zhvillohet turizmi dmth kushti është të jetë në mjedisin rural. Vendosja e turistëve bëhet jo vetëm në shtëpitë e

¹ www.unwto.org (15.02.2011)

² Zikov.M., "Hapësira rurale në kushte të reja të zhvillimit në Republikën e Maqedonisë", "Hapësira rurale në kushte të reja të zhvillimit", libri 1, fq.1, UKIM PMF, Shkup, 2006

³ Markoski.B., "Mjedisi rural në Republikën e Maqedonisë", Hapësira rurale në kushte të reja të zhvillimit", libri 1, fq.1, UKIM PMF, Shkup, 2006

⁴ "Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural", 2010

⁵ Statev. V., "Turizmi I fshatit ", Faber, Veliko Trnovo, 2007

nikoqirit të fshatit, por edhe në hotele, motele, kampe dhe pushimore në afërsi të nikoqirit. Në tabelën nr 1 është treguar krahasimi midis turizmit urban dhe rural.

Tabela nr 1, Krahasimi midis turizmit urban dhe rural

Turizmi / urban për pushim	Turizmi rural
Pak hapësirë e hapur	Hapësirë shumë e hapur
Vendbanimet mbi 10,000 banorë	Vendbanimet nën 10,000 banorë
Banuar dendur	banuar rrallë
Mjedis i ndërtuar	Mjedisi jetësor natyror
Shumë aktivitete në hapësirë të mbyllur	Shumë aktivitete në hapësirë të hapur
Infrastruktura intensive	Infrastruktura e dobët
Argëtim i fortë /baza materiale	Bazë e fortë individuale për aktivitetet
Ndërmarrje të mëdha	Ndërmarrje të vogla
Pronësia nacionale/ndërkombëtare e firmave	Biznesi me pronësi lokale
Orari i plotë i punës për punë në turizëm	Kohë e shkurtuar për marrje me turizëm
Nuk është përfshirë ferma/ pylltaria	E përfshirë ndonjë fermë/pylltaria
Përkrahja vetëm për interesa turistike	Turizmi përkrah edhe interesa tjera
Të punësuarit mund të jetojnë larg nga vendi i punës	Të punësuarit shpeshherë jetojnë në afërsi të vendit të punës
Rrallë nën ndikimin e faktorëve sezonal	Shpesh nën ndikimin e faktorëve sezonal
Shumë mysafirë	Disa mysafirë
Raporte anonime me mysafirë	Raporte personale me mysafirë
Menaxhmenti profesional	Menaxhim amator
Atmosferë kozmopolite	Atmosferë lokale
Ndërtesa shumë moderne	Ndërtesa shumë më të vjetra
zhvillimj/ etikë për rritje	Etika konservative/kufizuar e rritjes
Pamje e ngjashme	Pamje speciale
Operacionet e gjera të marketingut	Operacione të vogla të marketingut

Atanasova dhe Baçvarova e definojnë turizmin rural si qëndrim afatgjatë apo të shkurtë në rajon rural, me qëllim të pushimit aktiv apo pasiv dhe vendosja në një objekt i cili nuk është detyrimisht në pronësi të nikoqirit të fshatit. Qëndrimi i turistëve është i lidhur me kontaktin e afërt me banorët lokal, njohja dhe vizita e arkitekturës autoktone, të monumenteve kulturore, historike dhe arkeologjike⁶. Stojanova e definoi turizmin rural si qëndrim në mjedisin rural, shtëpi, kamp apo në ndonjë objekt tjetër për vendosje i cili mundëson kontakt të afërt me nikoqirët dhe qasje të drejtpërdrejtë në afarizmin e tyre⁷. Tançeva e definon turizmin rural si plotësim i nevojave të turistëve të vendit dhe të jashtëm në zonat rurale me atraksione lokale apo rajonale dhe vlera kulturore si dhe përmes bashkëpunimit të institucioneve lokale dhe të ofruesve të shërbimeve⁸. Sipas Panov, turizmi i fshatit paraqet atë mënyrë të shfrytëzimit të kohës së lirë, i cili është i pakushtëzuar kryesisht me plotësimin e nevojave rekreative por edhe kulturore në hapësirat e mjediseve rurale⁹. Qasja tjetër në analizën e mjedisit rural e përcakton jo thjesht si turizëm në mjedisin rural, por formë e turizmit e cila duhet të jetë njëkohësisht dhe ekonomikisht efektive dhe e orientuar ekologjikisht. Për të përmbushur të priturat e turistëve për efektet nga prodhimi i ofruar ruralistik kemi ardhur në përfundim se ky lloj i turizmit duhet të zhvillohet si biznes familjar – dhe vetëm në këtë mënyrë do të mund të sigurojë kërkesat e lartpërmendura. Për të qenë ky biznes i suksesshëm, kusht i detyrueshëm është që nikoqirët të cilët ofrojnë prodhim të njohin karakteristikat e tij dhe të zgjedhin mënyrën më të mirë për bashkimin me veprimtaritë afariste të fshatit.

Definicionet e shqyrtuara për turizmin rural e japin bazën për krijimin e thelbit të turizmit rural dhe të karakteristikave të tij tipike. Për tu pranuar njëri apo definicioni tjetër apo kombinimi i definicioneve dhe njëkohësisht me këtë të lejohen ndryshimet në bazën për të cilën duhet dhënë sqarim vijues për turizmin rural, që në pajtim me gjendjen faktike duhet të konkretizohet dhe të precizohet. Karakteristikat mund të jenë:

- Mjedisi në të cilin realizohet turizmi – vend i banuar në mjedis rural me resurset e tij dhe karakteristikat specifike;
- Mundësitë për vendosje – vendet për vendosje dhe objektet për qëndrim tipike për mjedisin rural; dhe

⁶ Atanasova, M. Baçvarova.S., "Turizmi imfshatit dhe agrar në Bullgari", Avangard Prima, Sofje, 2006 fq.14

⁷ Stolnova. S. "Planifikimi dhe financimi I turizmit të fshatit", Universiteti "Pasi Hilendarski", Plovdiv 2008 fq.16

⁸ Tançeva V, "Përfitimet nga përfshirja aktive të fshatrave maqedonase në zhvillimin e turizmit rural" , nr1, MIT, Shkup, 2010 fq.289

⁹ Panov. N. "Mundësitë për zhvillimin e turizmit rural në Republikën e Maqedonisë" nga Kongresi i dytë i gjeografëve të republikës së Maqedonisë, UKIM PMF, Shkup, 2000 fq.259

- Mundësitë për pushim (aktiv dhe pasiv) – veprimtaritë të cilat mund të praktikohen (si veprimtari tipike dhe të përditshme për vendin e banuar ashtu edhe të rrugës)

Në këtë aspekt turizmi rural paraqet udhëtimin dhe qëndrimin në vendin e banuar në mjedisin rural, në vende të vogla për vendosje (shtëpi për mysafir, dhoma të veçanta, hotel familjar, kamp etj), të cilat mund , por edhe nuk duhet të jetë në pronësi të nikoqirit për të cilin prodhimi afarist fshatar është burim themelor i të ardhurave. Ekzistojnë mundësitë për pushim pasiv ashtu edhe aktiv (kalërimi, gjuetia, peshkimi, ecja dhe me lëvizjet me biçikletë) njohja me mënyrën tradicionale të jetës dhe të kulturës, kontaktet me banorët lokal, vizita e monumenteve natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike etj me çka shfrytëzohen të mirat e mjedisit rural. Turizmi rural mund të zhvillohet gjithkund dhe nga secili. Është e nevojshme të plotësohen më shumë faktorë, të cilët janë supozim për zhvillimin e këtij lloji të turizmit alternativ. Faktorët themelor të cilët mundësojnë ekzistimin e turizmit rural mund të formulohen në këtë mënyrë:

- Ekzistimi i vlerave natyrore dhe antropogjene turistike;
- Objektet bashkëkohore për vendosje;
- Faktori njerëzor;
- Përkrahja institucionale;
- Infrastruktura e ndërtuar sociale dhe prodhuese;
- Ekzistimi i kërkesës së vazhdueshme turistike, sigurimi i kërkesës së vazhdueshme të prodhimit rural turistik dhe shfrytëzimi efektiv i kapaciteteve për vendosje; dhe
- Rendi dhe ligjshmëria në mjediset rurale.

Todoroviq dhe Stetiç bëjnë ndarjen e objekteve për vendosje në turizmin rural në¹⁰:

- Shtëpi rurale me arkitekturë tradicionale;
- Apartamente dhe dhoma në shtëpi me arkitekturë bashkëkohore;
- Amvisëri bujqësore me EKO ofertë; dhe
- Hotele të vogla familjare rurale.

Në Japoni p.sh. hotelet të cilat merren me turizëm rural mund të ndahen në katër grupe: Grupi i parë është i financuar dhe i udhëhequr nga shteti, grupi i dytë është i financuar dhe i udhëhequr nga sektori privat, i treti është i financuar nga shteti por i udhëhequr nga banorët lokal dhe grupi i katërt janë hotele të financuara dhe të udhëhequr bashkërisht nga shteti dhe banorët lokal (partneriteti privat publik). Në Evropën perëndimore shënohet një tendencë e re në zhvillimin e turizmit rural, e cila është e pranishme edhe te ne. E lidhur me luksin e turizmit masovik dhe thjeshtësia e

¹⁰ Todoroviq. M, Shtetiç S., "Turizmi rural ", Fakulteti gjeografik, Beograd, 2009, fq.42

mjedisit rural. Për këtë qëllim pajisja e dhomave është përpunuar nga druri, guri, janë të aranzhuara shumë lule. Janë futur elemente të reja natyrore, uji në formë të ujëvarës dhe basene për notim. Në Maqedoni ky lloj i prodhimit turistik rural mund të takohet në Berovë (hotel Manastir¹¹), fshatin Jançe (hotel tuto), Demir Kapi (Popova Kula¹²), Nagoriçane e vjetër (etno fshati) etj. . Dhomat janë me mobile të drurit, shtylla përkatëse të drurit, mure të gurit, figura të gurit, banja moderne, sauna etj. Në Gjermani janë formuar hotele vegjra “Turizmi romantik”, të cilët janë në atë stil dhe ofrojnë për një çmim relativisht të lartë tërë kompleksin e komoditetit për pushim familjar, për mbajtjen e konferencave etj.

2. Rajonet në të cilat është i zhvilluar turizmi rural në Republikën e Maqedonisë

Hapësira e Republikës së Maqedonisë është e ndarë në mënyrë administrative në 85 komuna, së bashku me Qytetin e Shkupit. Shikuar në bazë të rajoneve statistikore shteti është i ndarë në tetë rajone: Shkupit 7,3%, Verilindor 9,3%, lindor 14,2%, juglindor 11%, Vardarit 16,2%, Poloshki 9,7%, Jugperëndimor 13,4% dhe rajoni i Pelagonisë 18,9% nga territori i vendit¹³.

Tabela nr 2. Turizmi në Republikën e Maqedonisë sipas rajoneve, 2008

	Republika e Maqedonisë	vardarit	lindore	jugperëndimore	juglindore	Pelagonisë	Poloshki	verilindor	Shkupit
Nr i dhomave	25 952	550	588	16 154	2 095	3 053	1 020	291	2 201
Nr i shtretërve	69 097	1 504	1 729	41 703	5 893	8 993	3 046	800	5 429
Gjithsej turistë	605 320	7 799	13 739	276 669	84 031	62 325	19 153	3 395	138 209
Turistë të vendit	350 363	3 200	9 230	193 662	62 892	49 039	9 931	1 296	21 113
Turistë të huaj	254 957	4 599	4 509	83 007	21 139	13 286	9 222	2 099	117 096
Gjithsej bujtje	2 235 520	13 861	28 449	1 452 205	260 351	171 928	45 345	5 130	258 251
Bujtje nga vendasit	1 648 073	6 022	18 137	1 202 890	216 540	145 182	26 260	1 887	31 155
Bujtje nga të huajt	587 447	7 839	10 312	249 315	43 811	26 746	19 085	3 243	227 096

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë, “Rajonet në Republikën e Maqedonisë 2009”, publikimi, 2010

Në ligjet për veprimtari hoteliere dhe turistike (nuk ekziston ligji për turizëm apo turizëm rural) të Republikës së Maqedonisë është përmendur se në familjet fshatare jepen shërbime për dhënien e dhomave dhe apartamenteve, pronar i të cilit apo bartësi i

¹¹ www.hotelmanastir.com.mk (15.02.2011)

¹² www.popovakula.com.mk (15.02.2011)

¹³ “Strategjia për zhvillim rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019”, 2009

të drejtës së shfrytëzimit është anëtarë i familjes fshatare dhe atë më së shumti dhjetë dhoma, përkatësisht 20 shtretër. Në familjet fshatare mund të përgatiten dhe të shërbehen ushqime të ngrohta dhe të ftohta, pije dhe pije kryesisht të prodhimit personal më së shumti për 50 persona (pjesëmarrësit e piknikut) njëkohësisht. Në familjet fshatare mund të jepen shërbime të degustimit të verës apo rakisë si dhe shërbimi me ushqim të prodhimit vendor në pjesën e rregulluar të objektit banues apo afarist, në hapësirë të mbyllur, të mbuluar me strehë apo në hapësirë të hapur më së shumti për 50 persona njëkohësisht. Shërbimet turistike në turizmin e fshatit dhe etno turizmin janë: marrja e kuajve, foto safari, përpunimi dhe shitja e artizanaleve vendore, suvenire, instrumente, dhe prodhime dhe shërbime tjera në familjen e fshatare.

Në strategjinë e zhvillimit të turizmit në Republikën e Maqedonisë përmendet se turizmi rural është veprimtari e re dhe përmenden 10 lokacione ekzistuese të turizmit rural: Brajçino, Vevçani, Galiënik, Zrnovci, Berovë, Pehçevë BANSKO, Smolare, Mokrino, Koleshino¹⁴. Këtyre lokacione do të kishim shtuar edhe Lazaropole, Varvara, Makedonski Brod, Krushevë, fshatrat e Prespës dhe të Pelisterit, Lesново, Dojran etj. Në vendin tonë nuk ekziston statistikë e saktë se sa objekte ofrojnë shërbime të lidhura me turizmin rural. Vlerësimi i autorëve është se rreth 250-300 objekte në mjedise rurale ofrojnë turizëm rural. Pjesa më e madhe e këtyre objekteve janë të përqendruara kryesisht në tre rajone: jugperëndimor, Pellagonisë dhe lindor.

3. Shqyrtimet përfundimtare

Duhet pasur parasysh se specifika e fshatrave maqedonase mund të lejoj zhvillimin e formës së turizmit rural me karakteristika të atyre mjediseve rurale në Evropë dhe në kontinente tjera. Në Maqedoni vështirë mund të realizohen praktikisht veçoritë karakteristike në definicionet e shumë autorëve për “turizëm agrar”, “turizmi i fermave” dhe “pushimi në oborrin e fshatit”, të cilat janë karakteristike për vendet e Evropës Perëndimore dhe SH.B.A . Shtëpitë e fermave me oborr të madh, të vendosura jashtë vendeve të banuara nuk ekzistojnë në Maqedoni apo janë raritet, si në periudhën e kaluar ashtu edhe për momentin. Kjo është rezultat i ndjenjës së zhvilluar fortë sociale të banorëve lokal të “jetoj midis njerëzve”.

Rekomandimet të cilat i japin autorët për zhvillimin e turizmit rural në Republikën e Maqedonisë janë:

- Ndryshimi i rregullativës ligjore dhe definimi i saktë i veprimtarive të lidhura me turizmin rural;;
- Baza statistikore e të dhënave për objektet të cilat ofrojnë turizëm rural;
- Bashkimi i sipërmarrësve të cilët ofrojnë turizëm rural në nivel rajonal;
- Hulumtimi i kërkesës për prodhimin e turistik rural;
- Strategjia nacionale e zhvillimit të turizmit rural;

¹⁴ “Strategjia nacionale për zhvillimin e turizmit 2009-2013”, 2009

- Shfrytëzimi më i madh i fondeve evropiane për zhvillim rural;
- Trajnimi nga ana e institucioneve të larta të arsimit dhe ministrive kompetente për banorët lokal të cilët marrin pjesë në turizmin rural; dhe
- Hapja e sektorëve të turizmit në kuadër të komunave të cilat planifikojnë të zhvillojnë turizmin rural.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Atanasova, M. Blçarova.S., "Turizmi imfshatit dhe agrar në Bullgari", Avangard Prima, Sofje, 2006
2. Lane, B., "What is rural tourism?", Journal of sustainable tourism, V. 2, I. 1&2, 1994
- 3 Markoski.B., "Mjedisi rural në Republikëne Maqedonisë", Hapësira rurale në kushte të reja të zhvillimit", libri 1, fq.1, UKIM PMF, Shkup, 2006
4. Panov. N. "Mundësitë për zhvillimin e turizmit rural në Republikën e Maqedonisë" nga Kongresi i dytë i gjeografëve të republikës së Maqedonisë, UKIM PMF, Shkup, 2000
5. Statev. V., "Turizmi I fshatit ", Faber, Veliko Trnovo, 2007
6. "Strategjia për zhvillim rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019", 2009
7. Stolnova. S. "Planifikimi dhe financimi I turizmit të fshatit", Universiteti "Pasi Hilendarski", Plovdiv 2008
8. "Strtegjia nacionale për zhvillimin e turizmit 2009-2013", 2009
9. Tançeva V, "Përfitimet nga përfshirja aktive të fshatrave maqedonase në zhvillimin e turizmit rural" , nr1, MIT, Shkup, 2010
10. Todoroviq. M, Shtetiç S., "Turizmi rural ", Fakulteti gjeografik, Beograd, 2009, fq.42
11. "Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural", 2010
12. Zikov.M., "Hapësira rurale në kushte të reja të zhvillimit në Republikëne Maqedonisë", "Hapësira rurale në kushte të reja të zhvillimit", libri 1, fq.1, UKIM PMF, Shkup, 2006

Internet:

- www.hotelmanastir.com.mk (15.02.2011)
- www.unwto.org (15.02.2011)
- www.popovakula.com.mk (15.02.2011)